



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:079279
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05686612

E.nr.1210/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve Sh.B. dhe F.E. nga Ferizaj, të cilët i përfaqëson av Samir Rekaj nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtoria Komunale e Arsimit Ferizaj, për pagesën e pagave të pa paguara, dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.1210/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1210/23, të datës 04.08.2023 e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Drejtoria Komunale e Arsimit në Ferizaj, për pagesën e pagave të pa paguar, dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2023:079279, të dt.26.05.2023.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 30.06.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 3,623.83 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1210/23, më datë 15.05.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi